


Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.435/350-37307 datë: 22.07.2021
REFERENC-Ë:	07Nr.350/37307 datë: 02.07.2021
PËR/TO:	Lab OIL SH.P.K, me përfaqësues Raif Gashi Magjistratja Prishtinë-Shkup
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	<i>UD DREJTORI:</i> Nexhmije Loshi Durmishi IDA <i>Zyrtare e lartë për ndërtimtarë:</i> Doruntina Bytyqi ing.dipl.ndërt
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Lejen Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350/37307 datë: 02.07.2021 nga **Lab OIL SH.P.K, me përfaqësues Raif Gashi**, për Leje Ndërtimore për objektin me destinim Pompë për derivate të naftës, me etazhitet P+0, në parcelën kadastrale 1635-0 Zona Kadastrale Sopijë, pronë e Lab OIL SH.P.K sipas çertifikatës me nr.235/2020 datë:29.06.2021, andaj pas shqyrtimit të lëndës ky organ vendosi, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Data:22.07.2021

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.435/350-37307

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Komunal 01Nr.5821 date 05.03.2008, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Lab OIL SH.P.K, me përfaqësues raif Gashi nga Prishtina, DUP lëshon këtë:

**AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:

Emri:	Lab OIL SH.P.K, me përfaqësues Raif Gashi	Nr. Personal:	
Adresa:	Magjistralka Prishtinë-Shkup	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350/37307 datë: 02.07.2021

Emri i Projektit:	OBJEKT –POMPË PËR DERIVATE TË NAFTËS		
Emri i Projektuesit:	"KIC Planners"		
Adresa:	Rr."Tring Smajli" nr.76, Kati i dytë 10000		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II

Adresa: Rr."Ibrahim Rugova"-SUHAREKË

Zona(t) Kadastrale: Sopijë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Çertifikata me numer referues 235/2021 datë 29.06.2021 pronë e Lab-OIL Sh.P.K	1635-0	Y= 7484426.730 Y= 7484414.015 Y= 7484429.954 Y= 7484442.669	X=4688261.915 X=4688269.779 X=4688295.548 X=4688287.684

Lloji i ndërtimit të propozuar:

Pompë për derivate të naftës

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Face2nga5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr. 026, Suharekë - Kosovo | telefon: 029 271 318
www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net

Kategoria II			
Gabariti:	P(15.51m' x 30.30m') T(13.15m' x 15.51m') Z(13.20m' x 46.70m')	Katshmëria:	P+0 me sipërfaqe bruto të objektit sipas llogaris në taksen administrative 1642.58².
Vija rregullative:	Nga aksi i rrugës së planifikuar "Ibrahim Rugova" 22.5m' Nga aksi i rrugës së planifikuar "Dëshmorët e Atlantikut" 8.0m'	Vija ndërtimore:	Nga vija rregulluese e rrugës "Ibrahim Rugova" 7.0m' Nga vija rregulluese e rrugës "Dëshmorët e Atlantikut" 7.0m'

Përshkrimi
Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Lab OIL SH.P.K, me përfaqësues Raif Gashi i lejohet ndërtimi i objektit me pompë për derivate të naftës me etazhitet P+0. Lokacioni i objektit është në kuadër të PZhK 01Nr.5821 datë 05.03.2008, ku sipas gjendjes së planifikuar, parcela kadastrale 1635-0 është Zonë Ndërtimi dhe Zonë zgjerimi në të ardhmën, sipas Projektit kryesor hartuar nga KIC Planners Prishtinë. Objekti ka karakter të përhershëm me katshmëri P+0. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Aktvendimit mbi Kushtet Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.180/350-55280 datë 18.03.2021. Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin. • Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme: - Informata mbi Lejen Ndërtimore; - Informata mbi Projektuesin; - Informata mbi Kontraktuesin; - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit. • Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: - Një kopje të kësaj leje ndërtimore; - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit; - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent; - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit; - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit; - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;

- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për çertifikatë të përdorimit
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Njoftimit rreth Kushteve ndërtimore, Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
 - Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
 - Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për çertifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Lab OIL SH.P.K, me përfaqësues Raif Gashi**, përmes kërkesës 07Nr.350/37307 datë: 02.07.2021, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim pompë për derivate të naftës, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendim mbi Kushte Ndërtimore 07Nr.180/350-55280 datë 18.03.2021 (kopje)
- Akvendimin e lejës së rrënimit 07Nr.434/350-40435 datë 22.07.2021.
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.prot.65/21, datës:06.04.2021 lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vlerësim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit-Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.127 datë:26.05.2021.
- Pëlqim Sanitar-nga Inspektori i Sanitarisë 09Nr.1199 datë:09.06.2021.
- Vendimin për kyqje në komunikacion rrugor-nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 01Nr.5524 datë:24.06.2021.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.551, datë:02.07.2021.

Faqe4nga5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 026, Suharekë - Kosovë | Telefon: 029 271 318
www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizimisuhareke@rks-gov.net

- Pëlqim mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjensia e Menagjimit të Emergjencës Nr.181/20, datë:05.05.2021.
- Vendimin e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis 02Nr.1384-2/21 datë 25.05.2021.
- Kordinatat e vendosjes së objektit sipas skicës së terrenit datë 19.05.2021 të punuar nga gjeodeti Hekuran Demiri me numër të licensës.
- Pëlqimin nga Raiffeisen Bank Kosovë J.S.C datë 15 Korrik 2021 për të drejtën e ndërtimit në parcelën kadastrale 01635-0 Zona Kadastrale Sopijë.
- Elaborati gjeomekanik
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit Identifikues

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Planit Zhvillimor Komunal 01Nr.5821 datë 05.03.2008 ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.


Sipas Njoftimit 07Nr.428/350-37307 datë 21.07.2021, parashtruesit të kërkesës i është caktuar lartësia e pagesës për leje ndërtimore në shumën prej 4,599.22 € dhe se për pagesën e kryer janë sjellë dëshmia nga NLB Banka Therandë me datë 21.07.2021, sipas faturës komunale nr.000730 të datës 21.07.2021.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.435/350-37307 datë: 22.07.2021

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- Dosjes së DUP-së



UD Drejtor i Drejtorisë:
 Nexhmije Loshi Durmishi IDA